

VENDIM
Nr.18, datë 9.3.2009

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA TË PËR FILLIM TË PROCEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3 dhe nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa “a” të rregulloreve të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. “Për fillim të procedurave për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike” dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për shoqërinë “OST” sh.a.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta